



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

**RREGULLORE
PËR
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA,
NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE 01. NR. 016-122568 TË DT. 29.12.2015**

GJILAN, DHJETOR 2016

Në bazë të nenit 12.2 pika c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008) dhe nenit 38 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe në zbatim të dispozitave të kreut II të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.2008), Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.12.2016, miraton:

RREGULLOREN

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE, 01. NR. 016-26468 TË DT. 11.03.2015

Neni 1

Te neni 3 i rregullores bazë:

- Te tarifa nr. 1 pas fjalës “martesës” vjen fjala “shtetësisë”,
- Pas tarifës 1 shtohet tarifat:
 - 1.1. me këtë përmbajtje: “Lëshimi i certifikatës dhe ekstraktit të lindjes, martesës, shtetësisë dhe vdekjes nga sistemi E-Kioska, tarifa është 1.00€”.
 - 1.2. për aplikime online, tarifa është 1.00€”
- Te tarifa 6 niveli i taksës nga 40 ngritët në 50€,
- Te tarifa nr. 15 modifikohet teksti dhe ka përmbajtje “Regjistrimet në LTHL,LTHM dhe LTHV”,
- Te tarifa nr. 16 modifikohet teksti dhe ka përmbajtje “Vendimi-procedura mbi ndryshimet në LTHL, LTHM dhe LTHV”,
- Te tarifa nr. 17 modifikohet teksti dhe ka përmbajtje “Vendimi- procedura e korrigjimit në LTHL, LTHM dhe LTHV.
- Te tarifa nr. 22 modifikohet teksti dhe ka përmbajtje: “Lëshimi i vërtetimit që nuk është i regjistruar në LTHL, LTHM dhe LTHV dhe lëshimi i vërtetimeve tjera sipas specifikave të ndryshme”,
- Te tarifa nr. 24 modifikohet teksti dhe ka këtë përmbajtje: “Ri-regjistrim dhe nxjerrja e aktit në LTHL, LTHM dhe LTHV” dhe niveli i taksës nga 1€ ngritët në 3€”
- Tarifa nr. 27 të fshihet.

Neni 2

Te neni 4 i rregullores bazë, tarifa:

- nr. 3 zvogëlohet nga “1500” në “1000”;
- nr. 4 zvogëlohet nga “750” në “600”;
- nr. 5 zvogëlohet nga “1500” në “1000”;
- nr. 12, 13, 14, 18, 24, 27, 28 dhe 29 fshihen.
- nr. 30 dhe 31 zvogëlohet nga “200” në 150”.

Neni 3

Te neni 5 i rregullores bazë:

- Te tarifa 11, pas tekstit shtohet teksti “- tarifa vjetore për m²”;
- Te tarifa 12, pas tekstit shtohet teksti “- tarifa vjetore për m²”;
- Te tarifa 13, riformulohet teksti dhe ka këtë përmbajtje: “Qarkullimi i ekraneve elektronike, reklamuese (lëvizëse) dhe reklamimi në automjete tjera në lëvizje nëpër qytet dhe qëndrimi (vendosja) në hapësira publike”.

- Pas tarifës 37 vjen tarifa e re me nr. 38 si në vijim:

Shërbimet e mbeturinave:	Tarifa bazë pa TVSH
1. Bartja e mbeturinave – Amvisnit	4.63
2. Kioskat, argjendaritë, fotografët, avokatët etj.	7.57
3. Serviset, butikët, këmbimoret etj.	5.40
4. Furrat, ordinancat, shitore ushqimore etj.	11.91
5. Shitoret ushqimore, shitore e tekstilit etj . Zona2	9.74
6. Restorantet, podrumet e pijeve etj. Zona 1	20.23
7. Pompat e benzinës, restorantet etj. Zona 2	18.13
8. Depo materiali ushqimorë, supermarketet etj.	25.78
9. Mishtoret, kooperativat bujqësore etj.	20.23
10. Kontejner 1.1 m ³	11.19
11. Kontejner 4.5 m ³	29.17

Neni 4

Te neni 6 i rregullores bazë, paragrafi 2.1 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:

- “Nga pagesa e Taksës dhe Tarifës komunale për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit lirohen Investuesit e:
 - 2.1. objekteve të karakterit të përgjithshëm publik dhe karakterit social, e të cilat ndërtohen nga mjetet buxhetore të nivelit Qendror dhe Lokal;
 - 2.2. objekteve të financuara-bashkë financuara nga donacionet dhe grandet e jashtme dhe Qeveria e Kosovës-Komuna e Gjilanit;
 - 2.3. objekteve të kultit fetar, të cilat shërbejnë për kryerjen e riteve fetare;
 - 2.4. objekteve të përfaqësive diplomatike - konsulare të shteteve të huaja;
 - 2.5. objekteve të familjeve të dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të UÇK-ës, viktimat civile, rastet sociale dhe personat me aftësi të veçanta dhe;
 - 2.6. objekteve familjare për kthim të qëndrueshëm të të zhvendosurve nga lufta.

- Paragrafi 2.2 fshihet dhe shtohet paragrafi i ri 3 me këtë përmbajtje:
“Nga tarifa për densitet lirohen:

- 3.1. poseduesit-Investuesit e lejeve të mëhershme;
- 3.2. objektet bujqësore të cilat subvencionohen nga donacionet, grandet qeveritare dhe komunale”.

-Te neni 6 i rregullores bazë, fshihen tarifat për leje mjedisore.

Te neni 6 i rregullores bazë, shtohet teksti “ si në vijim ” Taksa për leje ndërtimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës”

“Taksa për leje ndërtimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës të përcaktuara nga Drejtoria e urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe pas pëlqimit të marrë nga Ministria përkatëse, hynë në fuqi pas kalimit të afateve të përcaktuara me Ligjin për Ndërtimin dhe Udhëzimin Administrativ mbi Taksat Administrative për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës”.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës.

01. nr. 016-126416
Gjilan, më 29.12.2016

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku Rexhepi